



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr.351-4476/2025
Klinë, datë 12/02/2025

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 35 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nr.04/L-042 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.18/2011, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e menaxherit të kontratës, krytari i Komunës së Klinës, lëshon **këtë**:

V E N D I M

1. **LEJOHET**, kryerja e puneve shtese sipas kërkesës së menaxherit të projektit, nr.01-351-4476/25 të datës 11.02.2025 "Ndërtimi i Infrastruktura Nëntokësore dhe Mbitokësore në Sferkë- Volljakë- Qupevë", punime të cilat realizohen nga OE REA sh.p.k sipas kontratës nr.634-24-734-5-2-1/C722. Punet shtesë lejohen brenda limiteve dhe rregullave ligjore të prokurimit publik.
2. Arsyeja e lejimit të puneve shtese perkatasisht dhënia e këtij pelqimi, behet më kërkesë të menaxherit, për shtimin e kryerjes së puneve të paparashikuara më qëllim të realizimit të projektit në teresi sipas standardeve.
3. Ky vendim lëshohet më kërkesën e menaxherit të projektit e cila është pjese perberese e këtij vendimi së bashku më paramasat dhe parallogarite e punëve shtese të cilat nuk mund të kalojnë 10 % të vlerës së përgjithshme të projektit.
4. Zbatimi i ketij vendimi behet nga ana e zyres së prokurimit në bashkepunim më DUMM dhe operatorin kontraktues.

Të njoftohen:

- Zyra e Prokurimit;
- DUMM- menaxheri i kontratës
- Punekryesi, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

